

Për:	Operatorë Ekonomik: NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me adresë në Baballoq – Deçan Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: 19.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I), me adresë në Baballoq – Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, Numër i brendshëm: 623-22-025-5-1-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I), me adresë në Baballoq – Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, Numër i brendshëm: 623-22-025-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 01.08.2022, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54*
- III. Vërejtje: Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I), me adresë në Baballoq – Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.08.2022**, të publikuar në ueb-faqe: <https://c-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **19.08.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

1. Bazuar ne kriteret e vendosura mendoj qe i eshte pershtatur dikujt si kriter ose eshte vendosur gabimisht ne dosje ne piken : **EN-ISO 50001-2012 (Certifikata për Menaxhimin të Energjisë për Kompaninë)** ky iso standard eshte per menaxhim te energjisë andaj ne proceduren e tille ndertim i sheshit na duket qe eshte i panevojeshëm dhe nuk kërkohet ne tendera te kesaj natyre.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO:

EN-ISO 50001-2012 (Certifikata për Menaxhimin të Energjisë për Kompaninë)

Dëshmia 4: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali.

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,

Korrigjohet në:

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:

Certifikata ISO: EN-ISO 50001-2012 (Certifikata për Menaxhimin të Energjisë për Kompaninë)

Për këtë aktivitet te prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes se Tenderit.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

2. Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (bulevarde ose sheshe), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.1,500,000.00 €.
- Konsiderojm se është kufizuar natyra e referencav pasi është kërkuar punime të ngjajshe dhe në kllapa është cekur (bulevarde ose sheshe),mendoj që duhet të zgjerohet natyra e referencav pasi që ky shesh ka shumë pozicione si psh Ndertimi i tregut , parkingje nëntokesore , ka pllato me sipërfaqe të madhe qka do të thotë ka edhe ndërtime të larta në konsiderojm se duhet të kerkohen edhe referenca të natyrës së tillë po ashtu shtruarje të rrugëve me kubeza dhe pllaja ka të betonit duke e bazuar në projektin e këtij tenderi , pra kërkojm edhe

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (bulevarde ose sheshe), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min.1,500,000.00 €.

Dëshmia 3: Lista e projekteve të kryera në lëmin e punëve të ngjashme (bulevarde ose sheshe), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëlosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Pranimit teknik.

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara,

Korrigjohet në:

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:

Kontrata të natyrës së ngjashme (bulevarde ose sheshe),

Për këtë aktivitet të prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes së Tenderit - bulevarde ose sheshe

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

3. Dëshmia 7 Operatori Ekonomik duhet të paraqes Metodologjinë për realizimin e punimeve dhe Elaboratin e punës – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Tek kjo pike kërkoj definim të kërkesë zakonisht në këtë pike gjithmonë është kërkuar Plan Dinamik kështu që ta kemi të qartë a bëhet fjalë për të njëjtin sen vetëm me emërtim të ndryshëm ?

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarohet se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2) është kërkuar:

Kërkesa 7: Metodologjia për realizimin e punimeve dhe Elaborati i punës,

Ku Qëllimi është të kërkohet nga Operatori Ekonomik ofertuesin, prezantimin e një dokumenti, ku do të prezantoj kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve që kërkon projekti në fjalë. Dokumenti është sintezë dhe proces i veçantë ku do të ketë detajime për hapat dhe metodologjinë e punës që do të ndiqet.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Komuna e Rahovecit